



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Senati Akademik

Nr. 4139 Prot

Shkodër, më 22. 4. 2019

V E N D I M

Nr. 393 datë. 22.4.2019

**"PËR MIRATIMIN I PAKETËS SË UDHËZIMEVE TË PROVËS FINALE NË
UNIVERSITETIN E SHKODRËS"**

Në mbështetje të ligjit me Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 37/1, neni 38, pika 1/d, Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" datë 02.03.2018 neni 17, pika 1, pika 6/r, Senati Akademik në mbledhjen e radhës të datës 22.11.2019.

V E N D O S I:

1. Miratimin e Paketës së Udhëzimeve të Provës Finale në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (sipas materialit bashkangjitur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Adem BEKTESHI

Konceptoi: Sekretare e SA

Prof.as.dr.Mirjam Dibra





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Nr. prot

Shkodër me 22/11/2019

PAKETA E UDHËZIMEVE PËR PROVËN FINALE
(Programet Master)

1. Hyrje

Për të fituar diplomën e studimeve master studentët që ndjekin programet Master Profesional dhe Master Shkencor, pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e studimeve, duhet t'i nënshtrohen edhe provës finale (mbrojtje të temës së diplomës). Kjo paketë përmban udhëzime për procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të diplomës; përmban përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie.

2. Përgjegjësitë e palëve të përfshira në procesin e provës finale

2.1. Përgjegjësitë e strukturave të USH

- a. Të mbështesë njesitë baze për zbatimin e udhëzimeve të përgatitjes dhe të mbrojtjes së punimit të provës finale.
- b. Të mbikëqyrë veprimtarinë e njesive baze për provën finale.
- c. T'u ofrojë studentëve mbështetjen dhe kushtet e nevojshme për realizimin e punimit të provës finale.

2.2. Përgjegjësitë e njesive baze për provën finale

- a. Të përcaktojë llojet e punimeve të diplomës sipas specifikave të programit master.
- b. Të përcaktojë procedurat e përgatitjes dhe të mbrojtjes së punimit të diplomës në rregulloren e programit të studimit.
- c. Të hartojë çdo vit një listë me temat që janë në studim në fushat që mbulojnë programet e studimeve master.
- d. Të garantojë se temat e propozuara janë të përshtatshme për fitimin e diplomës.
- f. Të miratojë udhëheqës të punimit të diplomës një pedagog të USH, ose një bashkëpunëtor i USH i kategorise Profesor ose gradës shkencore Doktor që është njohës dhe kontribues i fushës nga e cila është përzgjedhur punimi që ai do të udhëheqë.
- g. Të kujdeset se të gjithë studentët kanë udhëheqësin e punimit të diplomës.
- h. Të përcaktojë numrin maksimal të studenteve për një udhëheqës.
- i. Të miratojë temat dhe udhëheqësit e punimeve të diplomës.
- j. Të garantojë se diplomantët i plotësojnë standardet për të kryer punimin.
- k. Të interesohet për t'u siguruar kandidatëve konsulencën e nevojshme.
- l. Të garantojë se për zhvillimin e tezës zbatohen standardet e kërkimeve shkencore.

m. Të shqyrtojë raportet e progresit të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësi/t ka/kanë kontakt të rregullt me studentin.

n. T'ua bëjë të njohura udhëzimet përkatëse të gjithë studentëve.

2.3. Përgjegjësitë e udhëheqësit

- a. Të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së punimit të diplomës
- b. Të japë mbështetjen akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të punimit: ndihmën për formulimin e titullit, përgatitjen e platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të informacionit, konsulencën për përgatitjen e punimit etj. Udhëheqësi ka përgjegjësinë të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës.
- c. Të mbajë takime të rregullta me studentin për konsulencë dhe për të qenë në dijeni të ecurisë së punimit.
- d. Të vlerësojë rregullisht progresin e studentit.
- e. Të ndihmojë studentin për përgatitjen e prezantimit të punimit të tij para Komisionit të Vlerësimit
- f. Të bëjë vërejtjet e duhura brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes të konfirmojë se punimi i plotëson standardet e kërkuara për fitimin e diplomës.

2.4. Përgjegjësitë e studentit

- a. Të njohë rregullat e procedurave të provës finale.
- b. Të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për provën finale.

3. Llojet e provës finale

Prova finale është një punim nëpërmjet të cilit studentit demonstroi kompetencat tërësore për zotërimin e diplomës master. Ajo mund të jetë:

- a. dosje profesionale,
- b. projekt zbatimi,
- c. demonstrim profesional,
- d. tezë e kërkimit

4. Procedura e propozimit të punimit të provës finale

- a. Në fillim të semestrit të parë të vitit të fundit për programet Master, studentit duhet t'i dorëzohet propozimi për punimin e diplomës strukturore drejtuese të programit.
- b. Propozimi për punimin e diplomës paraqitet me një formular të veçantë, i cili merret të koordinatori i programeve Master ose pranë strukturore drejtuese të programit.
- c. Struktura drejtuese e programit, 10 ditë pas datës së caktuar për dorëzimin e propozimeve, shqyrton përshtatshmërinë e propozimit me kërkesat për provën finale dhe miraton udhëheqësin e punimit të diplomës.

- d. Në raste të jashtëzakonshme, kandidati mund të kërkojë ndërrimin e udhëheqësit të punimit të diplomës. Në këto raste, struktura drejtuese të programit, merr vendim pas 15 ditësh nga paraqitja e kërkesës.

5. Struktura e punimit të provës finale

5.1. Struktura e punimit përcaktohet nga secila njësi që mbulon programin në përputhje me specifikat e fushës.

5.2. Struktura e tezës së kërkimit

a. Punimi shkencor i diplomës duhet të përbëhet nga këto pjesë kryesore.

- Permbledhje shqip
- Abstrakti anglisht
- Tabela e përmbajtjes
- Studimi
Bibliografia
Shtojca

b. Struktura e detajuar e punimit të diplomës përcaktohet sipas specifikave të programeve të studimit.

c. Studenti dorëzon dy kopje të printuara dhe kopjen dixhitale

5.3. Kërkesa teknike për tezën

A. Formatit

Punimi i tezës së diplomës duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.

- Abstrakti në shqip dhe e rekomandueshme në anglisht të jetë jo më pak se 200 fjalë. Përdoret madhësia 10-she e shkronjave. Kjo duhet t'u mundësojë lexuesve të kuptojnë si ësh të trajtuar çështja në studim.
- Abstrakti në anglisht është kërkesë e standardeve ndërkombetare.

B. Punimi i tezës

- Punimi për diplomën MP të ketë, si rregull, jo më pak se 25 faqe kompjuterike; për diplomën MSH jo më pak se 30 faqe kompjuterike.
- Lloji i letrës të jetë format A4.
- Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letrës.

- Të gjitha kopjet e studimit duhet të jenë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të jenë të lexueshme lehtësisht. Dorëshkrimet nuk pranohen.
- Teksti shtypet me hapësirë një e gjysëm ndërmjet radhëve. Hapësira njëshe përdoret për përgatitjen e tabelave të gjata, ekstrakteve, shënimeve, shpjegimeve të gjata, bibliografisë.
- Lloji i shkrimit duhet të jetë Times New Roman. Masa e shkronjës në tekst duhet të jetë 12-she.
- Tabelat dhe figurat të përfshihen në tekst, ato të vendosen në qendër të faqes, brenda marxhinave. Çdo tabelë/figurë i duhet vendosur një numër referimi me shifër arabe. Numri i tabelës/figurës duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket.

C. Materialet shoqëruese

Nëse teza përmban materiale shoqëruese të tilla, si: CD/DVD ose USB kompjuteri, video ose kaseta, etj., që janë një pjesë e rëndësishme e punimit, ato duhet t'i bashkëngjiten punimit.

6. Etika e kërkimit

- a. Punimi duhet të jenë punë origjinale e kandidatit.
- b. Të gjitha citimet nga punimet e të tjerëve të vendosen në thonjëza dhe të shënohet burimi.
- c. Nëse pasazhet e marra nga të tjerët janë më të gjata se pesë radhë nuk futen në thonjëza, por shënohet referenca për to.
- d. Sqarimet e mundshme të kandidatit duhen futur në kllapa katrorë.
- e. Nëse burimi origjinal nuk gjendet, por burimi është përmendur në një dokument tjetër, atëherë të dy dokumentet, burimi original dhe burimi dytësor të shënohen.
- f. Udhëheqësit të sqarojnë që në fillim të punës se asnjë lloj mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature nuk do të tolerohet.
- g. Si rregull studenti duhet të përdorë referime nga libraria digitale.

7. Mbrojtja dhe vlerësimi i punimit të diplomës

7.1. Mbrojtja e punimit

- a. Mbrojtja e punimit duhet:
 - Të vlerësojë formimin e diplomantit për fushën dhe interesat e tij kërkimore.
 - Të konfirmojë se punimi i prezantuar është punë e kandidatit dhe përbën një kontribut për fushën përkatëse
- b. Mbrojtja e punimit është publike
- c. Procedura e mbrojtjes së punimit të diplomës përfshin:

1. Paraqitjen e përmbledhur të punimit nga diplomanti për 10-15 minuta.
2. Pyetje dhe përgjigje rreth punimit nga Komisioni i Vlerësimit.
3. Vlerësimi me shkrim nga oponenti (reçensuesi)
4. Vlerësimi i Komisionit të Vlerësimit.

7.2. Vlerësimi i punimit

7.2.1. Ngritja e Komisionit të Vlerësimit

Komisioni i vlerësimit të punimit të diplomës propozohet nga Përgjegjësi i njësisë bazë të programit përkatës dhe miratohet nga Përgjegjësi i njësisë kryesore. Komisioni përbëhet nga tre pedagogë të USH ose specialistë të fushës që janë bashkëpunëtorë të USH. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit duhet të jenë me tituj të kategorisë Profesor ose gradë shkencore Doktor.

7.2.2. Kriteret e vlerësimit

Për vlerësimin e punimit të diplomës anëtarët e Komisionit të Vlerësimit duhet të mbajnë parasysh këto kritere:

- demonstrimin e një vetëdije profesionale në trajtimin e temës së zgjedhur; përdorimin e metodologjisë shkencore dhe të instrumenteve të kërkimit; origjinalitetin e punimit;
- dobinë e punimit;
- cilësinë e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit, respektimi i rregullave të drejtshkrimit);
- paraqitjen e qartë dhe formimin e një tërësie koherente; (respektimi i kërkesave të formatit dhe kërkesave teknike);
- cilësinë e prezantimit.

7.2.3 Vlerësimi i punimit të diplomës bëhet me sistemin e pikëve si më poshtë:

Shkalla e pikëve	Përshkrimi i notës
95-100	10
85-94	9
75-84	8
65-74	7

55-64	6
45-54	5
1-45	4

Vlerësimi i punimit të mbrojtjes jepen nga komisioni në fund të mbrojtjes.

7.3. Mosmarrëveshjet e komisionit


Kur ka mosmarrëveshje midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit për përmbushjen e standardeve të punimit, vendimi merret me shumicë votash.

Miraturar nga Senati Akademik I USH

Vendimi Nr. _____, datë _____ 2019

Kryetari i Senatit

Prof.dr. Adem Bekteshi



PROJEKT PROPOZIM PËR PROVËN FINALE

1. Të dhëna të përgjithshme

Emri i studentit: _____

Programi i studimit: _____

2. Lloji i punimit të provës finale

a. Tezë kërkimi të mirfilltë

a. Projekt kërkimi

b. Dosje kërkimi

c. Seri esesh

d. Tezë kërkimi të zbatuar

e. Projekt zbatimi

f. Dosje profesionale

i. Demonstrim profesional

3. Titulli i punimit _____

4. Udhëheqësi i propozuar

Emri, mbiemri: _____

Titulli/Grada: _____

Fusha e ekspertizës: _____

Institucioni ku punon: _____

Adresa e kontaktit: _____



Kriteret e vleresimit

Nr.	Kriteret e vlerësimit
1.	Demonstrimi i një vetëdije profesionale në trajtimin e çështjes së zgjedhur (përcaktimi i qartë i çështjes kërkimore, përputhja e trajtesës me temën, përshkrimi dhe analiza e thellë rezultateve, paraqitja e përfundimeve dhe rekomandimeve)
2.	Përdorimi i metodologjisë shkencore dhe i instrumenteve të kërkimit (përcaktimi i detyrës shkencore në përputhje me temën, përcaktimi i hipotezave ose i pyetjeve kërkimore, përcaktim i subjekteve, i kampionit, përzgjedhja e metodave dhe e instrumenteve të përshtatshëm)
3.	Originaliteti i punimit (formulimi origjinal i temës, këdvështrimi origjinal i temës, struktura origjinale, rezultate dhe analiza origjinale)
4.	Dobia e punimit (dobia e punimit për zhvillimin e teorisë, për zbatimin në praktikë, për studime të mëtejshme)



5.	Cilësia e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit dhe i rregullave të drejtshkrimit)
6.	Paraqitja teknike (respektimi i kërkesave teknike të formatit të punimit)
7.	Cilësia e prezantimit (komunikimi me audiencën, ekspresiviteti, përdorimi i mjeteve)